

VENDIM
Nr. 757, datë 19.12.2025

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 836, DATË 26.12.2024, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË
KAMZË, MIRDITË, SHIJAK DHE KRUJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 836, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2025, nga Bashkia Shijak, në masën 72 928 638 (shtatëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të banesave individuale në Bashkinë Shijak.”;

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Efekti financiar do të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet Bashkisë Shijak, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama